



Pranimi / Received	29. 12. 2020	viti / year	2020
Organ / Organi	SKMBICK	Shtesa / Prilog / Appendix	1/3
Organ / Jedinita / Org. / Unit	3340/2020	Sasia / Kolicina / Quantity	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.375/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti- anëtar, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.375/2020 të datës 26.11.2020 të parashtruar nga ankuesja [REDACTED] të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat Sylejman Klinaku, me adresë "Ulipiana C-2", 2/6 në Prishtinë, kundër organit të punësimit/ Ministria e Drejtësisë, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 29.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.375/2020 e datës 26.11.2020 e parashtruar nga ankuesja [REDACTED]

A r s y e t i m

Ankuesja [REDACTED], sipas Aktemërimit të datës 31.12.2016, ka qenë e punësuar në pozitën "Specialiste e Toksikologjisë", në Departamentin e Mjekësisë Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë.

Me Vendimin e datës Nr.113/2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Mjekësisë Ligjore, Ministria e Drejtësisë të datës 23.10.2018, ankueses [REDACTED] "Specialiste e Toksikologjisë", në Departamentin e Mjekësisë Ligjore, i ka përfunduar marrëdhënia e punës nga data 23.11.2018, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Me këtë vendim ankueses i është njohur edhe e drejta e pagesës së një page të njëhershme në vlerën e pagës së fundit e cila ankueses i është kompensuar në muajin nëntor 2018.

Ankuesja, [REDACTED], e pakënaqur me mos njohjen e të drejtës së pagesës së tri (3) pagave me rastin e pensionimit, sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, më datë 12.11.2020 ka parashtruar kërkesë për kompensimin 3 pagave jubilarë tek Ministria e



Drejtësisë. Pas marrjes së përgjigjes së datës 13.11.2020, nga Ministria e Drejtësisë, ankuesja me datë 26.11.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2774/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 30.11.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Drejtësisë. Më datë 10.12.2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Drejtësisë, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2774/2020 të datës 26.11.2020 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontratës e Punësimit e datës 03.01.2013 të ankueses; Kërkesën për shpërblim jubilar e datës 12.11.2020 e ankueses; Përgjigjen në shkresën e datës 12.11.2020 e datës 13.11.2020; Autorizim për shërbime ligjore i datës 19.05.2020; Libreze Pune; vendim i datës 01.02.2019; Vendimin me Nr. 113/2018 i datës 23.10.2018; Formulari i të dhënave për listë të pagave i datës 09.11.2018; Kërkesë për pagesë retroaktive i datës 09.11.2018; Kërkesë e datës 06.05.2014; Vendim i datës 17.10.2011; Akt Emërimit të datës 06.05.2014; Lista e punëtorëve të Institutit të Mjekësisë Ligjore; E-mailin e datës 23.12.2020 nga [redacted] për [redacted] E-mailin e datës 28.12.2020 nga [redacted] për [redacted]; E-mailin e datës 28.12.2020 nga [redacted] për [redacted].

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted], është parashtruar **jashtë afatit ligjor, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar gjitha provat e lëndës të ofruara nga ankuesja dhe organi i punësimit dhe ka konstatuar se në bazë të Vendimit me numër Nr.113/2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Mjekësisë Ligjore, Ministria e Drejtësisë të datës 23.10.2018, ankueses [redacted] "Specialiste e Toksikologjisë", në Departamentin e Mjekësisë Ligjore, i ka përfunduar marrëdhënia e punës nga data 23.11.2018, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Ankuesja që nga data 23.11.2018, e që është data e pensionimit të ankueses e deri me datë 12.11.2020 kur me kërkesë për kompensimin e pagave jubilarë ju ka drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, nuk ka ndërmarr asnjë veprim ligjor, respektivisht ankuesja nuk ka ofruar asnjë dëshmi që ka parashtruar ankesë në kuadër të institucionit të punësimit, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave ku përcaktohet se: „Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në bazë të Vendimit me numër Nr.113/2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Mjekësisë Ligjore, të datës 23.10.2018, ankueses me datë 23.11.2018 i ka përfunduar marrëdhënia e punës me arritjen e moshës së pensionimit, ndërsa me datë 26.11.2020 ankuesja e ka parashtruar ankesën me

numër protokoll 2774/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *jashtë afatit ligjor* të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ", në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesa e ankueses është e palejuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.375/2020

Avdyl BEKETESHI

Be Keteshi
Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Malsore Gashi Bajraktari
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankueses Avokat [REDACTED]
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë;
- Drejtorit të Përgjithshëm në IML, Ministria e Drejtësisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Drejtësisë, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

